



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. 730 Prot.

Tiranë, 09.12.2021

URDHËR

Nr. 199, datë 09.12.2021

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES
PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E
KANDIDATËVE PËR KOMISIONER NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT
TË POPULLIT**

Në zbatim të neneve 2, 33 e 33/1, të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, si dhe të nenit 5 të Rregullores së Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e institucionit të Avokatit të Popullit",

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores "Për procedurat dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për Komisioner në institucionin e Avokatit të Popullit", sipas lidhjes nr.1 që i bashkëlidhet këtij Urdhri.
2. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori i Kabinetit.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

AVOKATI I POPULLIT

ERINDA BALLANCA



RREGULLORE

PËR PROCEDURAT DHE KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE PËR KOMISIONER NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregullore është organizimi dhe funksionimi i punës në institucionin e Avokatit të Popullit, në kuadër të procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve për Komisioner në institucionin e Avokatit të Popullit.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave e procedurave standarde të punës që do të ndiqen për përzgjedhjen e kandidatëve për komisioner pranë institucionit të Avokatit të Popullit.

Neni 3

Parimet e përgjithshme

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve për Komisioner në institucionin e Avokatit të Popullit udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e transparencës, shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës e profesionalizmit.

Procesi i përzgjedhjes është i hapur dhe publik. Avokati i Popullit organizon procesin për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidatëve në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Procesi i përzgjedhjes në të gjithë fazat do të karakterizohet nga bashkëpunimi mes palëve dhe qartësia e dokumentacionit mbi bazën e të cilit kryhet vlerësimi dhe arrihet vendimarrja.

Neni 4

Shpallja e vendit vakant dhe mënyra e aplikimit

1. Në rastin e përfundimit të mandatit të Komisionerit, institucioni i Avokatit të Popullit, jo më vonë se tre muaj përpara përfundimit të mandatit publikon shpalljen për vendin vakant të komisionerit. Në këtë shpallje ka të drejtë të aplikojë çdo shtetas i cili plotëson kushtet e parashikuara në nenin 33 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

2. Shpallja e vendit vakant për komisioner përmban:

- a) Pozicionin konkret sëbashku me një përshkrim të shkurtër;
- b) Fazat në të cilën do të kalojë procesi i përzgjedhjes;
- c) Kushtet e përgjithshme dhe kriteret objektive në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar;
- d) Fushën përkatëse të njohurive mbi të cilat do të vlerësohen kandidatët gjatë fazës së vlerësimit, ku përfshihen instrumentet/dokumentet kryesore ndërkombëtare si dhe aktet kryesore specifike në varësi të pozicionit/pozicioneve përkatëse për të cilat është hapur konkurrimi;
- e) Listën e dokumenteve që duhet të dorëzohen dhe mënyrën e dorëzimit të tyre;
 - Kërkesa për shprehje interesi për të kandiduar për pozicionin e shpallur;
 - Një kopje të plotë të jetëshkrimit (CV) ku të përfshihet adresa e saktë e vendbanimit, një numër telefoni dhe adresa elektronike (e-mail);
 - Librezën e punës ose dokumenta të tjerë të barazvlefshëm që vërtetojnë eksperiencat profesionale të kandidatit;
 - Diplomën e studimeve universitare të nivelit “Master Shkencor” ose të ekuivalentuar me të që vërteton se ka mbaruar arsimin e lartë juridik;
 - Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
 - Deklaratë personale që nuk është anëtar i partive politike, deputet, ministër apo zëvendësministër;
 - Deklaratë personale lidhur me integritetin e lartë moral dhe pastërtinë etiko-morale të figurës;
 - Formularin e aplikimit për informim për zyrtarët përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta;
 - Çdo dokument që provon ecurinë gjatë kryerjes së arsimit të lartë thellimin e njohurive, marrjen e titujve shkencorë apo kualifikimit në fushën e të drejtave të njeriut dhe ligjit, ose veprimtarinë e njohur në opinionin publik, në mbrojtjen dhe nxitjen e respektimit të të drejtave dhe lirive të shtetasve si dhe njohuritë e gjuhëve të huaja;
 - Deklaratë personale që dokumentat e dorëzuar janë të plotë e gjithëpërfshirës.

- f) Afatin e dorëzimit të përcaktuar me datë të saktë kalendarike;
- g) Mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

3. Afati i aplikimit do të përcaktohet në shpallje dhe do të jetë jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike duke filluar nga data e nesërme e publikimit të shpalljes dhe përfundon në orën 16.30 të ditës së pesëmbëdhjetë. Nëse dita e fundit e afatit bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.

4. Strukturat e institucionit të Avokatit të Popullit kanë përgjegjësinë për publicizimin e kësaj shpallje në të gjithë rrjetet e informimit të publikut apo në institucione të tjera me qëllim përhapjen e informacionit në mënyrë sa më të gjerë.

5. Kandidatët duhet të dorëzojnë aplikimin e tyre në 2 kopje personalisht pranë institucionit të Avokatit të Popullit ose në rrugë postare. Dokumentacioni i dorëzuar duhet të shoqërohet nga një inventar.

Neni 5

Kushtet ligjore

Komisioner mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që në momentin e kandidimit përmbush këto kushte ligjore:

- a. të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, diplomë “Master shkencor” ose tituj të ekuivalentuar me të;
- b. të ketë vjetërsi në profesion si jurist jo më pak se 10 vjet;
- c. të mos jetë i dënuar penalisht me vendim të formës së prerë;
- ç. të mos jetë anëtar i partive politike, deputet, ministër, zëvendësministër.

Neni 6

Kriteret objektive

Kandidati që përmbush kushtet ligjore, të përmendura më sipër, zgjidhet komisioner në bazë të këtyre kriterëve objektive:

- a. vjetërsisë në profesion;
- b. ecures gjatë kryerjes së arsimit të lartë dhe gëzimit të titujve shkencorë;
- c. njohurive të thelluara dhe/ose kualifikimit në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të ligjit;

- ç. veprimtarisë së njohur në opinionin publik, në mbrojtjen dhe nxitjen e respektimit të të drejtave dhe lirive të shtetasve;
- d. të gëzojë integritet të lartë moral dhe figurë të pastër etiko-morale;

Neni 7

Fazat e procesit të vlerësimit

Procesi i vlerësimit të kandidatëve për Komisioner në institucionin e Avokatit të Popullit do të zhvillohet në tre faza:

- a. Faza e seleksionimit paraprak.
- b. Seanca dëgjimore.
- c. Përzgjedhja nga Avokati i Popullit sëbashku me vlerësimin e tij për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore nga kandidatët.

Neni 8

Faza e seleksionimit paraprak

1. Në fazën e seleksionimit paraprak do të vlerësohet vetëm mbi bazën e dokumentacionit të dorëzuar nëse kandidatët i plotësojnë kushtet ligjore, të përcaktuara në nenin 5 të kësaj rregullore.

2. Vlerësimi do të kryhet nga një grup pune i cili ngrihet me Urdhër të Avokatit të Popullit. Ky grup kryesohet nga Sekretari i Përgjithshëm i institucionit dhe në të merr pjesë nëpunësi përgjegjës për burimet njerëzore në institucion dhe dy punonjës të tjerë të institucionit të caktuar nga titullari.

3. Dokumentacioni i kandidatëve që kanë shprehur interesin për vendin vakant administrohet nga Sektori i Burimeve Njerëzore i cili harton një inventar të detajuar të dokumentacionit të dorëzuar. Inventari hartohet në dy kopje ndër të cilat një kopje administrohet në dosjen e aplikantit dhe tjetra i jepet aplikantit.

Sektori i Burimeve Njerëzore ia përcjell dosjet për vlerësim Grupit të Punës të ngritur sipas pikës 2 të këtij neni.

Menjëherë pas përfundimit të afatit të aplikimit, njësia e burimeve njerëzore i dërgon zyrtarisht Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit, formularët e plotësuar nga kandidatët me qëllim verifikimet përkatëse nga ky institucion.

4. Grupi i punës, brenda 5 ditëve pune nga përfundimi i afatit të aplikimit verifikon dokumentacionin dhe përgatit një raport ku evidentohen kandidatët që i plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe ata që nuk i plotësojnë këto kushte, sëbashku me arsyet e moskualifikimit. Ky raport i njoftohet Avokatit të Popullit.

Me mbylljen e afatit të aplikimit, institucioni i Avokatit të Popullit publikon listën e kandidatëve e cila u njoftohet njëkohësisht në rrugë elektronike të gjithë kandidatëve.

5. Kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e përgjithshme njoftohen individualisht nga Sektori i Burimeve lidhur me mosplotësimin e kushteve ligjore. Atyre u lihet në dispozicion një afat 3 ditor për të paraqitur kundërshtimet e tyre në lidhje me arsyet e moskualifikimit (nëse kanë).

6. Pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 5, grupi i punës, nëse është rasti, merr edhe një herë në shqyrtim dosjet e kandidatëve që kanë paraqitur parashtrime, dhe harton raportin përfundimtar të kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe atyre që nuk i plotësojnë këto kushte. Ky raport i njoftohet Sektorit të Burimeve Njerëzore në institucionin e Avokatit të Popullit.

7. Sektori i Burimeve njerëzore njofton individualisht:

- Kandidatët që nuk janë kualifikuar, për arsyet e moskualifikimit;
- Kandidatët e kualifikuar për datën, orën dhe vendin ku do të zhvillohet faza e dytë e procesit të konkurrimit.

Neni 9

Seanca dëgjimore

1. Të gjithë kandidatët që kalojnë fazën e seleksionimit paraprak, do t'i nënshtrohen seancës dëgjimore me Komisionin Ad-hoc.

2. Në këtë seancë dëgjimore në varësi të pozicionit për të cilin aplikohet, kandidatët duhet të paraqesin një *propozim/platformë* të qartë në përputhje me dokumentat dhe instrumentat kryesorë ndërkombëtarë e kombëtarë, si dhe me Strategjinë, Planin e Veprimit dhe Raportet Vjetore të Institucionit të Avokatit të Popullit, ku të përfshihet:

- prezantimi i kandidaturës;
- prezantimi i këndvështrimit mbi problematikat e fushës në të cilën aplikohet;
- propozimi mbi çështjet që duhet të trajtohen me përparësi;
- propozimi mbi politikat në fushën specifike të të drejtave të njeriut;

propozimi mbi mënyrën e manaxhimit dhe drejtimit të seksionit/mekanizmit, etj.

3. Seanca dëgjimore është e hapur dhe publike dhe në të ftohen të marrin pjesë si vëzhgues organizatat e shoqërisë civile, mbrojtësit e të drejtave të njeriut, përfaqësues nga Kuvendi ose aktorë të tjerë publikë që kanë interes për këtë proces. Njoftimi për zhvillimin e seancës dëgjimore, përfshirë datën orën dhe vendin e zhvillimit të saj, si dhe listën përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar njoftohen publikisht të paktën 3 (tre) ditë para datës së caktuar.

4. Në rast të mosparaqitjes së kandidatit në seancën dëgjimore, për arsye objektive të vërtetuara nga vetë kandidati, seanca mund të shtyhet vetëm një herë për atë kandidat.

Neni 10

Komisioni Ad-hoc

1. Vlerësimi në fazën e seancës dëgjimore do të kryhet nga një Komision Ad-Hoc i cili ngrihet me Urdhër të Avokatit të Popullit, menjëherë pas përfundimit të fazës së seleksionimit paraprak të kandidaturave.

2. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, kryesohet nga Avokati i Popullit dhe ka në përbërje përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile apo mbrojtës të të drejtave të njeriut, të përzgjedhur sipas nenit 11 të kësaj rregullore.

3. Secili nga anëtarët e Komisionit Ad-Hoc ka detyrimin për deklaram në rast të gjendjes së konfliktit të interesit me një apo më shumë kandidatë.

Neni 11

Përzgjedhja e organizatave të shoqërisë civile

1. Procesi i përzgjedhjes për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturave për Komisioner në institucionin e Avokatit të Popullit organizohet në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile apo mbrojtësit e të drejtave të njeriut, që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut e cila lidhet me fushën e veprimtarisë së Seksionit/Seksioneve përkatëse ku do të përzgjidhen kandidaturat për Komisioner.

2. Sëbashku me shpalljen e vendit vakant sipas nenit 4 të kësaj rregullore, insitucioni i Avokatit të Popullit publikon shpalljen për shprehjen e interesit nga organizatat e shoqërisë civile /mbrojtësit e të drejtave sipas pikës 1.

3. Organizatave të shoqërisë civile apo mbrojtësve të të drejtave të njeriut u lihet në dispozicion një afat prej 10 (dhjetë) ditësh për të shprehur interesin e tyre.

4. Avokati i Popullit përzgjedh 4 organizata të shoqërisë civile apo mbrojtës të të drejtave të njeriut të cilët kanë veprimtari të njohur në fushën e të drejtave të njeriut ose në fushën e cila lidhet me fushën e veprimtarisë së Seksionit/Seksioneve përkatëse ku do të përzgjidhen kandidaturat për Komisioner.

Organizatave të tjera të shoqërisë civile/mbrojtësve të të drejtave të njeriut që kanë shprehur interesin ftohen të marrin pjesë në procedurë në cilësinë e vëzhguesit.

Neni 12

Vlerësimi në fazën e seancës dëgjimore

1. Kandidatët pjesëmarrës në fazën e seancës dëgjimore do të vlerësohen në bazë të një sistemi vlerësimi, duke u mbështetur në:

- a. vjetërsinë në profesion;
- b. ecurinë gjatë kryerjes së arsimit të lartë (preferohet nota mesatare mbi 8) dhe gëzimin e titujve shkencorë;
- c. njohuritë e thelluara dhe/ose kualifikimet në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të ligjit;
- d. njohuritë e të paktën një prej gjuhëve zyrtare të Bashkimit Evropian;
- e. veprimtarinë e njohur në opinionin publik, në mbrojtjen dhe nxitjen e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut;
- f. integritetin moral dhe pastërtinë etiko-morale të figurës (sipas përcaktimeve të legjislacionit specifik);
- g. vlerësimin e propozimit/platformës;
- h. intervistën me komisionin.

2. Komisioni Ad-Hoc, për intervistën me gojë harton një listë me pyetje për kandidatët, me qëllim realizimin e një vlerësimi sa më gjithpërfshirës. Intervista e strukturuar me gojë ka për qëllim vlerësimin e jetëshkrimit, të njohurive, aftësive dhe formimit të kandidatëve.

3. Komisioni Ad-Hoc, në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton renditjen/listimin e kandidatëve të cilat i përcillen Avokatit të Popullit.

4. Në diskutimin e renditjes është e preferueshme që vendimmarrja e Komisionit Ad-Hoc të jetë unanime. Në rast se Komisioni Ad-Hoc nuk arrin në një vendimmarrje unanime, kjo duhet të pasqyrohet në relacionin/raportin e përgatitur nga Komisioni Ad-Hoc i cili i dërgohet Avokatit të Popullit për vendimarrje përfundimtare në përzgjedhjen e kandidaturave.

Neni 13

Përzgjedhja nga Avokati i Popullit

1. Pas përfundimit të procedurave të mësipërme, Avokati i Popullit, bazuar në vlerësimin e tij për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore dhe renditjen e kandidaturave, sipas preferencës së tij, si edhe në raportin e Komisionit Ad-Hoc, do të përzgjedhë katër kandidatë për secilin vend vakant, nga lista e kandidatëve të vlerësuar.

2. Lista e katër kandidatëve për secilin vend vakant, së bashku me vlerësimin e Avokatit të Popullit për përmbushjen e kushteve ligjore dhe kriterëve objektive, i përcillet Komisionit të Kuvendit që mbulon çështjet ligjore, brenda 5 ditëve pune nga përfundimi i vlerësimit të Komisionit *ad hoc*.

3. Të gjithë kandidatët njoftohen në rrugë individuale lidhur me rezultatin e vlerësimit. Lista e kandidatëve të përzgjedhur publikohet në faqen zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit.

Neni 14

Dispozita të fundit

Një kopje e të gjithë dokumentacionit që pasqyron procedurën e ndjekur për përzgjedhjen e kandidaturave sipas dispozitave të kësaj rregullore, përfshirë kopja e dosjes së kandidatëve, administrohen në arkivën e institucionit të Avokatit të Popullit.